

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. **Informacione te pergjitheshme**

“KANANI”, është themeluar si nje shoqe sh.p.k.
Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2021 DEPO FARMACI..

2. **Permbledhje e politikave kontabel**

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar ‘Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare’ dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (“lekë”).

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftushme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatat e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej te treteve dhe në te njëjtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursët e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2021 janë 1 euro=123.58 leke dhe 1 dollar= 101.2 leke.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2021 është 15 %.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivitet afatgjata materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe mbi bazen e vleren se mbetur per pjesen tjetere te aktiveve te qendrueshme. Normat e perdorura jane ne ndertesa 5 % te vleres fillestare dhe per aktivet e tjera 20% te vleres se mbetur.

Gjendjet e inventaret

Vlerësimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjelle inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kosto mesatare të blerjeve të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

3. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare në banke dhe arke, në leke dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 janë si më poshtë:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2021		Gjendja ne 31.12.2020	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	LEK	1,531,559	508,348	5,733,936	1,979,563
Arka ne leke	LEK	15,800,802	-	2,013,477	-
Shuma		17,332,361	508,348	7,747,413	1,979,563.00

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të bankes respektive.

4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor2020
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	626,934	531,942
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme klient	6,052,212	12,200,976
(iii) Instrumente të tjera borxhi	0	0
(iv) Investime të tjera financiare	0	0
Shuma	6,679,146	12,732,918

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2021 deklarohen si vijon:

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " jane pasqyruar faturat e papaguara per shitjet qe shoqeria ka realizuar gjate ushtrimit si dhe tepricat debitore te marrdhenieve me klientet.

Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" perfaqesojne tepricen debitore te tepricen debitore te "Shteti-tatim mbi fitimin" e t.vsh tepre per shumen prej 626.934 lek .Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

5. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Inventari		
(i) Lëndët e para	-	-
(ii) Prodhim në proces	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për rishitje	17,883,323	13,337,148
(v) Parapagesat për furnizime	-	-
Shuma	17,883,323	13,337,148

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2021. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kosos se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar".

Drejtimi mendon se vlere e paraqitur eshte vlere me e ulet mes kosos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

6. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Aktivitet të tjera afatgjata materiale	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2021	-	2,850,000	670,000		3,520,000
Shtesat	-	-	52,000		52,000
Pakesimet	-	-	-	-	-
Kosto e AAM-ve 31.12.2021	-	2,850,000	722,000	-	3,572,000
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2021	-	2,224,422	623,958		2,848,380
Amortizimi ushtrimit	-	-	-	-	-
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2021	-	2,224,422	623,958	-	2,848,380
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2021	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-
Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2021	-	-	-	-	-
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2021	-	625,578	46,042	-	723,620
Vlera neto e AAM-ve 31.12.2021	-	625,578	98,042	-	723,620

7. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Huate dhe parapagimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2021 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Huamarrjet		
(i) Huate dhe obligacionet afatshkurtra		
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata		0
(iii) Bono të konvertueshme	0	0
Shuma	0	0

8. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2021 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Huate dhe parapagimet		
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	24,937,811	22,263,206
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	0	0
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore	967,438	15,002
(iv) Hua të tjera	0	0
(v) Parapagimet e arkëtuara	0	0
Shuma	25,905,249	22,278,208

“Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e

Ilogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2021.

"Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" perfaqesojne detyrimin per sigurimet shoqerore e tatim qiraje e t.f te muajit dhjetor 2021 ne shumen 967438 leke .

9. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2021 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Huatë afatgjata		
(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare		
(ii) Bonot e konvertueshme	0	0
Shuma	0	0

10. Kapitale e veta

11. Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2021 ai eshte 100.000 leke, i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 100 leke /kuota. Gjate ushtrimit kontabel 2021 nuk ka rritje ose pakesim ne kapitalin e rregjistruar te shoqerise dhe ndryshime ne raportet zoterimit nga ortaket.

12. Fitimi (humbja) e vitit financiar

▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2020	31
Te ardhurat nga shitja e produkteve	0		0
Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve(ndertimi)			
Te ardhurat nga shitja e mallrave	35,596,315	24,514,359	
Te ardhurat te tjera	5,828,422	2,238,484	
Shuma	41,424,737	26,752,843	

Të ardhurat nga shitja e mallrave jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja. Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

▪ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2021 jane treguar ne pasqyren perkatese.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Shpenzime te tjera		
Blerje materiale te pa stokueshme	-	-
Nentrajtime te pergjitheshme	462,700	156,769
Qira	963,864	722,898
komisione banke	157,721	45,156
Taksa vendore	112,100	112,100
Shuma	1,696,385	1,036,923

▪ **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)	-	-
Shpenzimet per interesat 767, 668(-)		
Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)	-	1
Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)	-	-
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		-
Shuma	-	1

-Shpenzime personeli

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

Kategorite	Ushtrimi 2021 (000 leke)			Ushtrimi 2020 (000 leke)		
	Numer mesatar	Paga	Sgurime punedhenesi	Numer mesatar	Paga	Sgurime punedhenesi
Administrator, menaxher	1	30	8	1	30	8
Puntor	1	62	15	1	30	8
Shuma	2	92	23	2	60	16

13. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2021 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT	6,246,104	1,339,994
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	-	-
1	Amortizime tej normave fiskale	-	-
2	Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3	Gjoha,penalitete,demshperblime	-	-
4	Provizione qe nuk njihen	-	-
5	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	-	-
6	Te tjera-materiale jashte perdorimit(pa miratim)	-	-
III	PJESA E HUMBUES SE MBARTUR(-)	-	-
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	6,246,104	1,339,994
V	Shpenzimi i tatim fitimit-15%	936,916	200,999
VI	FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	5,309,188	1,138,995

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiscal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

14. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , veç huase se marre nga bankat nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

15. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare. Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2021 eshte rritur shifra e afarizmit dhe fitimi tregtar.

Administratori i Shoqerise